# Formular për SYLLABUS të Lëndës

| Të dhëna bazike të lëndës | |
|---|---|
| Njësia akademike: | **Letërsi shqipe** |
| Titulli i lëndës: | **Letërsi për fëmijë** |
| Niveli: | BACHELLOR |
| Statusi lëndës: | **Obligative** |
| Viti i studimeve: | **I** |
| Numri i orëve në javë: | **3+2** |
| Vlera në kredi – ECTS: | **6** |
| Koha / lokacioni: | |
| Mësimëdhënësi i lëndës: | **Dr. Besim Muhadri** |
| Detajet kontaktuese: | **besimmuhadri@yahoo.com, tel. 045 401 275** |
| | |
| Përshkrimi i lëndës | Në kursin ***Letërsi për fëmijë*** do të jepet një ide e përgjithshme e**kronologjisë** së letërsisë botërore për fëmijë, jo për ta spikatur parimin e "historisë", por veprat *si entitete artistike* të autorëve më të shquar të saj. Kjo kërkon si përfilljen e **letërsisë së huaj**, ashtu edhe të **letërsisë kombëtare** për fëmijë, që nga fillimet e deri në ditët e sotme.Për një pamje më të plotë të larmisë së tipologjive të teksteve kemi mbishtresuar edhe parimin **gjinor** e atë **tematik**. Për nevoja të paraqitjes, do të trajtohen edhe disa koncepte teorike të domosdoshme, duke filluar me një përpjekje për përkufizimin e veçorive të letërsisë për fëmijë. |
| Qëllimet e lëndës: | Programi i kësaj lënde ka për qëllim që t'i njohë studentët me vlerat kulminante letrare në fushën e letërsisë për fëmijë, me elementet e para të bazës teorike të L.F.R, njohuri mbi traditën dhe zhvillimin e krijimtarisë letrare për fëmjë si dhe të kenë njohuri të mjaftueshme për të gjitha llojet letrare të kësaj natyre.. |
| Rezultatet e pritura të nxënies: | Në përfundim të lëndës studentët do të jenë të qartë për zhvillimin kronologjik dhe do të njohin mirë autorët e veprat më të spikatura të letërsisë për fëmijë, të huaj e kombëtare. Ata do të njohin mirë specifikat artistike, psikologjike e moshore të letërsisë për fëmijë;<br>Ata do të kenë një përvojë të mirë teorike e praktike për njohjen dhe depërtimin me pavarësi në tekstet në fjalë;<br>- Gjithçka do të jetë në funksion të mësimdhënies së lëndëve të leximit në shkollë. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | |
| **Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)** | | | |
| **Aktiviteti** | **Orë** | **Ditë/javë** | **Gjithësej** |
| Ligjërata | 3 (135 min) | 15 | 34 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | | | |
| Punë praktike | 1 (45 min) | 15 | 11 |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 10 min | 15 | 2.5 |
| Ushtrime në teren | | | |
| Kollokfiume,seminare | 5 | 1 | 5 |
| Detyra të shtëpisë | 20 min | 15 | 5 |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 3 | 15 | 45 |
| Përgaditja përfundimtare për provim | 2 | 15 | 30 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final) | | | |
| Projektet,prezentimet ,etj | 1 | 1 | 1 |
| **Totali** | | | **133,5 orë**<br>**133,5:25 = 5,34**<br>**6 ECTS** |
| | | | |
| **Metodologjia e mësimëdhënies:** | Mënyra e mësimdhënies do të përfshijë metoden verbale ( Monolog dhe dialog ) metodën ilustrative dhe demonstrative etj. | | |
| | | | |
| **Metodat e vlerësimit:** | Përcjellja e punës së gjithmbarshme të studentëve bëhet në mënyrë të vazhdueshme përmes protokolleve të vazhgimit, punimeve me shkrim, diskutimeve të mbarështruara në burimet relevante dhe me vlerësimet e para dhe të dyta intermediare. Për secilën veprimtari të angazhimit mbimesatar të studentëve fitohen pikë të veçanta. Studentët kanë mundësi të grumbullojnë deri në 100 pikë, varësisht nga niveli i angazhimit të tyre në punën e drejtëperdrejtë arsimore të leximit në kohën e tyre të lirë,hartimit të punimeve me shkrim etj. | | |
| **Literatura** | | | |
| **Literatura bazë:** | 1. Bishqemi, Astrit. *Histori e letërsisë botërore për fëmijë*. Sejko, Elbasan, 2006. | | |

| | |
|---|---|
| | 2. Bishqemi, Astrit. *Histori e letërsisë shqiptare për fëmijë*. ShB "Dy lindje & perëndime", Tiranë, 2008.<br>3. Gjokutaj, Tasim. *Letërsia për fëmijë*. Botimet Toena, Tiranë, 2007 |
| **Literatura shtesë:** | Gaçe, Bardhosh. *Letërsia shqipe për fëmijë* . Triptik, Vlorë, 2005. |

| **Plani i dizejnuar i mësimit:** | |
|---|---|
| **Java** | **Ligjerata që do të zhvillohet** |
| ***Java e parë:*** | Paraqitja e programit dhe e burimeve të literaturës etj. Përkufizimi dhe objekti i LF; dallimet e saj nga letërsia për të rritur.-Letërsia e lexueshme nga fëmijët dhe të rinjtë. Nga fabulat e Ezopit deri tek La Fonteni. |
| ***Java e dytë:*** | Sharl Peró si themelues i përrallës letrare për fëmijë; analizë: ***Hirushja, Kësulëkuqja, Maçoku me çizme, Gishtua, E bukura dhe bish,*** Vëllezërit Jakob & Vilhelm Grim; analizë e vëllimit me përralla ***Na ishte një herë*** |
| ***Java e tretë*:** | LBF në shekullin XIX. Veprat e para të mirëfillta për fëmijë e të rinj.-Ljuis Kerël dhe romani i tij ***Liza në botën e çudirave***. E mrekullishmja dhe fantastikja. |
| ***Java e katërt:*** | Hans K. Anderseni dhe vepra e tij letrare; analizë e përrallave: ***Sirena e vogël, Rrobat ereja të mbretit, Trëndafili dhe kërmilli, Rosaku i vogël i shëmtuar, Hija*** |
| ***Java e pestë:*** | -Karlo Kolodi dhe meritat e tij në letërsinë botërore për fëmijë.-Analizë e romanit ***Pinoku*** |
| ***Java e gjashtë*:** | Mark Tueni – pikëpamjet dhe veprat e tij letrare për të rinj.-Analizë e romanit ***Aventuart e Tom Sojerit*** |
| ***Java e shtatë:*** | -Zhyl Verni si themelues i letërsisë fantastiko-shkencore për fëmijë;-Analizë e romanit ***Dy vjet pushime*** |
| ***Java e tetë:*** | James M. Barrie dhe vepra e tij; analizë e romanit ***Piter Pan***.-Xhani Rodari - përrallëtar i kohëve moderne; elementi shkencor në krijimin e fantastikes.-Analizë e novelës ***Xhipi në televizor*** |
| ***Java e nëntë:*** | -LF e Rilindjes Kombëtare. Naim Frashëri, analizë e vëllimit ***Të vegjëlit***.<br>-K. Kristoforidhi: ***Gjahu i malësorëve***. P. K. Negovani: ***I*** |

| | |
|---|---|
| | ***vogli Donat Argjendi*.** |
| ***Java e dhjetë:*** | LF e viteve ’30; revistat dhe antologjitë për fëmijë; përkthimet nga LBF.<br>JAVA X-LF e Pasluftës. Petro Marko dhe romanet e tij për të rinj.-Analiza e romanit ***Shpella e piratëve***. |
| ***Java e njëmbedhjetë*:** | --M. Kuteli dhe analizë e përshtatjes për fëmijë: ***Tregime të moçme shqiptare***.-Odise Grillo dhe krijimtaria e tij; vëllimi poetik ***Pse ashtu e pse kështu.*** |
| ***Java e dymbëdhjetë*:** | -Gaqo Bushaka dhe seria e romaneve për Çufon.-Analizë e romanit ***Çufoja dhe Bubi Kaçurrel.*** |
| ***Java e trembëdhjetë*:** | -Ismail Kadare; poema ***Princesha Argjiro***. -Tasim Gjokutaj si lëvrues të poezisë dhe poemës për fëmijë; analiza e përmbledhjes ***Kushe hëngri akulloren*** |
| ***Java e katërmbëdhjetë*:** | LF pas vitit 1990. Zhvillimi i poezisë, prozës, fabulës dhe përrallës. Krijuesit: A. Deva, F.Lamaj, A. Bishqemi, A. Hurgulica, K. Mahila, Xh. Spahiu, G. Xhafolli.-Proza për të rinj nën përfaqësimin e Viktor Canosinaj; analizë e romanit ***Meriyll***. |
| ***Java e pesëmbëdhjetë*:** | -Përsëritje dhe konsultime për provimin përfundimtar. |

| **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:** |
|---|
| Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore:<br>➢ Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore;<br>➢ Te mbaj disiplinën gjatë ligjëratave;<br>➢ Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit në teste dhe provim;<br>Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet ti përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit. |